

VENDIM
Nr. 502, datë 17.7.2019

**PËR REVOKIMIN E TRANSFERIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 760, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË
NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË DISA PRONAVE ME VENDNDODHJE
NË ZONAT KADASTRALE 8250, 8240, 8190, 8150"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, Njësisë Administrative Tiranë, të pronës me numër rendor 10, të lidhjes 1, bashkëlidhur vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave.

2. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, prona me numër rendor 10, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, hiqet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per Inventarizimin e pronave te vecanta)										
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
6	8240 Tr-R-5	3/11	Truall	Rr. Kavajës	55.67		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol.6, fq 195
7	8240 Tr-R-5	3/54	Trotuar	Rr. Kavajës	495.07		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 6, fq 220
8	8240 Tr-R-5	3/322	Truall	Rr. Kavajës	557		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 2, fq 100
9	8190 TR-X-16	12/333	Sheeh	Rr. Shefqet Ndroqi	115		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, v.8, fq 68
10	8190 TR-X-16	12/285	Truall	Rr. Shefqet Ndroqi	858		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 21, fq 45 Ka ndërtim te pajligjshëm
11	8190 TR-X-16	12/290	Truall	Rr. Shefqet Ndroqi	4754	1523	Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 21, fq 49

